# e-Albania

## Udhëzuesi i Përdoruesit

## Shërbimi: Njoftim i Ndryshimeve në Regjistrim – Tatimpagues të regjistruar në QKB

**Autorësia: ikubINFO**
**Krijuar më: Mars 2021**

# Tabela e Përmbajtjes

Hyrje ..... 3
Aksesim i shërbimit ..... 3
Plotësimi i formularit ..... 4
Informacion i Përgjithshëm ..... 5
Seksioni 1: Ndryshim i Përgjegjësive Tatimore ..... 5
Seksioni 2: Ndryshim i statusit të Tatimpaguesit ..... 6
Seksioni 3: Ndryshim i Kategorisë së Sigurimeve ..... 6
Seksioni 4: Dokumentacioni ..... 6
Aksesim i dokumentave lidhur me aplikimin e kryer ..... 7

# Tabela e Figurave

Figura 1: Formulari i aplikimit për ndryshimin e të dhënave të tatimpaguesve të regjistruar në QKB ..... 4
Figura 2: Formulari i aplikimit për ndryshimin e të dhënave të tatimpaguesve të regjistruar në QKB - vazhdim ..... 5
Figura 3: Numri i aplikimit te "Mesazhet e Mia" ..... 6
Figura 4: Dokumentat e aprovimit/refuzimit të aplikimit ..... 7
Figura 5: Dokumenti i aprovimit të kërkesës për ndryshimin e të dhënave të tatimpaguesit ..... 8
Figura 6: Dokumenti i refuzimit të kërkesës për ndryshimin e të dhënave të tatimpaguesit ..... 10

# Hyrje

Shërbimi elektronik “Njoftim i Ndryshimeve në Regjistrim” mund të përdoret vetëm nëpërmjet llogarisë së biznesit në portalin e-albania Web si dhe në versionin Mobile të tij.

Në këtë shërbim mund të aplikojnë subjektet tatimpaguese, për të cilët ka ndodhur ndonjë ndryshim të dhënash nga ato të plotësuara në regjistrimin fillestar të tyre.

Pas kryerjes së aplikimit nga e-albania, ajo do të trajtohet me çështje nga inspektorët e administratës tatimore, të cilët do të marrin vendimin përfundimtar: Aprovim ndryshim të dhënash regjistrimi të tatimpaguesit ose Refuzim ndryshim të dhënash regjistrimi të tatimpaguesit duke dhënë arsyen përkatëse. Në të dy rastet tatimpaguesi që ka kryer aplikimin në e-albania, do t’i dërgohet dokumenti te menuja “Dokumentat e Mia” në e-albania.

Në rast se tatimpaguesi është regjistruar në QKB, atëherë do t’i shfaqet formulari përkatës, i cili do të trajtohet në këtë udhëzues përdoruesi.

Në rast se tatimpaguesi është regjistruar te Administrata Tatimore, atëherë do t’i shfaqet formular tjetër, i cili do të trajtohet në udhëzues tjetër përdoruesi.

Gjithashtu, tatimpaguesit mund të dërgojnë aplikime nga ky shërbim vetëm nëse statusi i tyre është i ndryshëm nga Çregjistruar dhe / ose Falimentuar.

# Aksesim i shërbimit

Për të aksesuar këtë shërbim duhet të ndiqen hapat e mëposhtëm:

1. Hyrja në e-albania me llogari biznesi
2. Kërko shërbimin me emrin “Njoftim i Ndryshimeve në Regjistrim” dhe klikoje atë
3. Kliko butonin “Përdor

# Plotësimi i formularit

Pasi klikohet butoni Përdor, do të shfaqet forma e plotësimit të formularit si më poshtë:



Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

FORMULAR APLIKIMI
NDRYSHIM I TË DHËNAVE TË REGJISTRIMIT PËR TATIMPAGUESIT QË ADMINISTROHEN NGA QKB

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

*Ju lutem lexoni shënimet përpara se të plotësoni formularin*

INFORMACION MBI TATIMPAGUESIN

NIPT* [redacted]

Emri i tatimpaguesit* Roland Mai

Detaje të ndryshimit *Kujdes, duhet të plotësoni vetëm ndryshimet*

Çfarë ndryshimesh po njoftoni?

- Ndryshim i përgjegjësisë për tatimet ☐ Shko në Seksionin 1
- Ndryshim i statusit të tatimpaguesit ☐ Shko në Seksionin 2
- Ndryshim i kategorizimit për sigurimet shoqërore ☐ Shko në Seksionin 3

SEKSIONI 1: NDRYSHIM I PËRGJEGJËSISË PËR TATIMET

1. Cilin tatim kërkoni të shtoni?*

- ☐ Tatim mbi të Ardhurat nga Punësimi
- ☐ Taksa Kombëtare
- ☐ Tarifa Kombëtare
- ☐ Tatimi mbi fitimin
- ☐ Tatim i Mbajtur në Burim
- ☐ Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore
- ☐ Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
- ☐ Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin
- ☐ Taksa e Rentës Minerare

Jepni qarkullimin dhe fitimin e parashikuar më poshtë

Qarkullimi i parashikuar deri në fund të vitit

Fitimi i parashikuar

*Figura 1: Formulari i aplikimit për ndryshimin e të dhënave të tatimpaguesve të regjistruar në QKB*




*Figura 2: Formulari i aplikimit për ndryshimin e të dhënave të tatimpaguesve të regjistruar në QKB - vazhdim*

Detajet e plotësimit të fushave lidhur me formularin e aplikimit janë si më poshtë:

## Informacion i Përgjithshëm

1. Fushat e **NIPT** dhe **Emri i Tatimpaguesit** janë të plotësuar automatikisht me të dhënat e biznesit të loguar në e-albania.
2. Duhet të zgjidhet të paktën një nga seksionet për të bërë ndryshimet në formular

## Seksioni 1: Ndryshim i Përgjegjësive Tatimore

Në këtë seksion mund të zgjidhet një ose më shumë përgjegjësi tatimore. Validimet që ekzistojnë janë:

1. Nuk mund të zgjidhet njëkohësisht Tatim Fitimi dhe Tatim i Thjeshtuar mbi Fitimin.
2. Në rast se zgjidhet përgjegjësi tatimore për të cilën është aktualisht i regjistruar tatimpaguesi, atëherë nuk do të lejohet dërgimi i aplikimit.

3. Në momentin e zgjedhjes së Tatim Fitimi apo Tatim i Thjeshtuar mbi Fitimin janë të detyrueshme plotësimi i fushave: Qarkullimi i parashikuar deri në fund të vitit dhe Fitimi i parashikuar.
    - Nëse është zgjedhur Tatim i Thjeshtuar Fitimi dhe vlera e vendosur te **Qarkullimi i Parashikuar** > 8,000,000, atëherë nuk do të lejohet dërgimi i aplikimit, pasi me këtë qarkullim tatimpaguesi duhet të regjistrohet për Tatim Fitimin.
    - Nëse është zgjedhur Tatim Fitimi, por jo Tatim mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) dhe vlera e vendosur te **Qarkullimi i Parashikuar** >= 10,000,000, atëherë nuk do të lejohet dërgimi i aplikimi pa zgjedhur edhe përgjegjësinë tatimore TVSH.

## Seksioni 2: Ndryshim i statusit të Tatimpaguesit

Në këtë seksion lejohet riaktivizimi i tatimpaguesit nga statusi Pasiv në statusin Aktiv.

## Seksioni 3: Ndryshim i Kategorisë së Sigurimeve

Në këtë seksion mund të zgjidhet vetëm një opsion si dhe në rast se zgjidhet kategoria e sigurimit për të cilën është aktualisht i regjistruar në sistem, atëherë nuk do të lejohet dërgimi i aplikimit.

## Seksioni 4: Dokumentacioni

Në këtë seksion lejohet vetëm ngarkimi i 5 dokumentave shoqërues. Ngarkimi i tyre është opsional.

Pas plotësimit në mënyrë të saktë të gjithë fushave, mund të klikohet butoni Dërgo aplikimin, i cili mundëson dërgimin e aplikimin në sistemin e taksave për t'u procesuar më tej nga inspektorët e administratës tatimore. Në klikim të butonit, do të shfaqet një pop-up me numrin e aplikimit përkatës.

Numri i aplikimit do t'i dërgohet individit edhe te **"Mesazhet e mia"**:




*Figura 3: Numri i aplikimit te "Mesazhet e Mia"*

# Aksesim i dokumentave lidhur me aplikimin e kryer

Pas procesimit nga administrata tatimore të aplikimit të kryer në e-albania për regjistrimin e një subjekti tatimpagues, individi që ka aplikuar do të mund të informohet lidhur me vendimin e marrë për këtë aplikim, te menuja "Dokumentat e Mia" në e-albania.




*Figura 4: Dokumentat e aprovimit/refuzimit të aplikimit*

Në rastin kur të paktën një ndryshim i të dhënave të tatimpaguesit është **aprovuar**, tatimpaguesit do t'i dërgohet në e-Albania **dokumenti i aprovimit të aplikimit**, i cili do të përmbajë vendimin mbi secilin ndryshim (aprovuar / refuzuar – arsye refuzimi). Formati i tij është si më poshtë:



Ministria e Financave
**Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve**

Data, 05/03/2021

**STATUSI APROVIMIT TË APLIKIMIT MBI NDRYSHIMIN E TË DHËNAVE TË TATIMPAGUESIT**

Statusi i aplikimit: Aplikimi juaj është aprovuar në çështjen numër [redacted]. Ky dokument do t'ju informojë mbi statusin e aplikimit për secilën kërkesë: Aprovuar/ Refuzuar si dhe arsyen e refuzimit të administratës tatimore për secilin aplikim për ndryshim.

| | |
|---|---|
| NIPT-i | [redacted] |
| Emri i tatimpaguesit | Roland Mai |
| Numri i çështjes | [redacted] |

**Detaje të ndryshimit**

**Seksioni 1**

Përgjegjësia Tatimore e kërkuar:

- ☐ Taksa e Rentës Minerare
- ☐ Tatim i Thjeshtuar mbi Fitimin
- ☐ Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
- ☐ Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore
- ☑ Tatimi i Mbajtur në Burim — Aprovuar
- ☐ Tatimi mbi Fitimin
- ☐ Tarifa Kombëtare
- ☐ Taksa Kombëtare
- ☐ Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi

| Qarkullimi i parashikuar deri në fund të vitit | Fitimi i parashikuar |
|---|---|
| | |

**Seksioni 2**

Riaktivizim nga pasivi ☑ — Aprovuar

**Seksioni 3**

Kategoria për efekt sigurimesh

- ☑ Punëdhënës — Refuzuar test
- ☐ I vetëpunësuar (I vetëm)
- ☐ I vetëpunësuar me punëmarrës
- ☐ I vetëpunësuar me punëmarrës dhe punonjës te papaguar të familjes
- ☐ I vetëpunësuar pa punëmarrës me punonjës të papaguar të familjes

**DREJTORIA RAJONALE E TATIMEVE TIRANË**

*Figura 5: Dokumenti i aprovimit të kërkesës për ndryshimin e të dhënave të tatimpaguesit*

Në rastin kur të gjitha ndryshimet për të dhënat e tatimpaguesit janë **refuzuar**, tatimpaguesit do t'i dërgohet **dokumenti i refuzimit** në e-Albania, i cili do të përmbajë statusin Refuzuar dhe arsyen e refuzimit të kërkesës për ndryshimin e të dhënave të tatimpaguesit. Formati i tij do të jetë si më poshtë:



Ministria e Financave

**Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve**

Data, 10/03/2021

**REFUZIMI I APLIKIMIT MBI NDRYSHIMIN E TË DHËNAVE TË TATIMPAGUESIT**

Statusi i aplikimit: Aplikimi juaj është refuzuar në çështjen numër [redacted]. Ky dokument do t'ju informojë mbi arsyen e refuzimit të administratës tatimore për secilin aplikim për ndryshim.

| | |
|---|---|
| NIPT-i | [redacted] |
| Emri i tatimpaguesit | Roland Mai |
| Numri i çështjes | [redacted] |

**Detaje të ndryshimit**

**Seksioni 1**

Përgjegjësia Tatimore e kërkuar:

- [ ] Taksa e Rentës Minerare
- [x] Tatim i Thjeshtuar mbi Fitimin — Refuzuar test
- [ ] Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
- [ ] Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore
- [ ] Tatimi i Mbajtur në Burim
- [ ] Tatimi mbi Fitimin
- [ ] Tarifa Kombëtare
- [ ] Taksa Kombëtare
- [ ] Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi

| Qarkullimi i parashikuar deri në fund të vitit | Fitimi i parashikuar |
|---|---|
| 8,000,000 | 8,000,000 |

**Seksioni 2**

Riaktivizim nga pasivi [x] — Refuzuar test

**Seksioni 3**

Kategoria për efekt sigurimesh

- [ ] Punëdhënës
- [ ] I vetëpunësuar (I vetëm)
- [ ] I vetëpunësuar me punëmarrës
- [ ] I vetëpunësuar me punëmarrës dhe punonjës te papaguar të familjes
- [ ] I vetëpunësuar pa punëmarrës me punonjës të papaguar të familjes

**DREJTORIA RAJONALE E TATIMEVE ELBASAN**

1

NR 2020 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Rruga "Gjin Bue Shpata", Web site : www.tatime.gov.al

*Figura 6: Dokumenti i refuzimit të kërkesës për ndryshimin e të dhënave të tatimpaguesit*